

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME TE KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APPELIT AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-50/12

**Prishtinë,
17 tetor 2013**

Në çështjen juridike të:

A.H

Pala ankuese

kundër

V.M

Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Elka Ermenkova, Kryetare e kolegjit, Esma Ertezi dhe Sylejman Nuredini, anëtar të kolegjit, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/112/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA56642), të datës 22 qershor 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 17 tetor 2013, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Miratohet si e bazuar ankesa e A.H nga fshati Zhegër, Komuna e Gjilanit.
2. Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/112/2011, i datës 22 qershor 2011, për aq sa ka të bëjë me lëndën e regjistruar me numrin KPA56642, për shkak të mungesës së jurisdiksionit.
3. Kërkesa e V.M e regjistruar si KPA56642 hedhet si e e palejueshme.
4. Obligohet paraqitësi i kërkesës që t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 60 (gjashtëdhjetë euro) brenda afatit prej 90(nëntëdhjete) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 26 nëntor 2007, V.M në cilësinë e anëtarit të familjes ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkonte që babai i tij Dragutin Mladenović të njëjti si pronar i ngastrës kadastrale nr.444 në vendin e quajtur “Tërška “,në sipërfaqe prej 0.30.11 ha, arë, të zonës kadastrale Zhegër ,Komuna e Gjilanit. Posedimi për këtë paluajtshmri është humbur me dt. 17 .qershor 1999. si rezultat i rrethanave në Kosovë në vitin 1998/1999; kërkon të drejtën e konfirmimit të pronësisë dhe ri posedimin.

Për të mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur në AKP këto prova shkresore edhe atë:

- Fletën poseduese nr.115 të Enti Gjeodezik i Republikës së Serbisë – Qendra Kadastrale e Paluajtshmerise Prishtine e Shërbimit Kadastral i Paluajtshmeise ne Gjilan, i dates 23 prill. 2002.Me këtë fletë poseduese konstatohet se titullar i së drejtës së pronësisë të ngastrës kadastrale që është objekt i kërkesës është D.M ,
- Certifikatën e vdekjes për D.M i dt.23.janar.2008, të lëshuar nga Komuna e Vranjës Republika e Sërbisë me të cilën konstatohet se ai ka vdekur me 04 nëntor 1998,

- Certifikatën e lindjes për V.M i dt.23.janar.2008, të lëshuar nga Komuna e Vranjës, Republika e Serbisë.

Në vitin 2008 AKP ka bërë njoftimin në lidhje me kërkesën duke e vendosur një shenjë në vendin ku supozohej se ndodhej ngastra. Në vitin 2010, AKP përsëri ka bërë njoftimin në lidhje me kërkesën, këtë herë duke e shpallur kërkesën në Gazetën Njoftuese nr. 6 dhe në Buletinin e Zyrës së Pronës të UNHCR-it. Gazeta dhe Lista i ishin lënë një pronari të një shitoreje në Përlepnice i cili kishte pranuar t'i vejë ato në dispozicion të palëve të interesuara. Publikimet e njëjta gjithashtu ishin lënë në hyrje dhe dalje të fshatit Zhegër si dhe në disa zyra publike në Gjilan.

Pasi që askush nuk ishte përgjigjur, kërkesa ishte trajtuar si e pa-kontestuar dhe KKPK me vendimin e vet KPCC/D/A/112/2011 të datës 22 qershor 2011 kishte miratuar kërkesën, ku ka vendosur se paraqitësi i kërkesës kishte dëshmuar se mbajtësi i së drejtës pronësore D.J.M ishte pronar i ngastrës.

Me datën 11 nëntor 2011 vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar paraqitësit të kërkesës.

Vendimi i KKPK-ës i është dorëzuar M.H me datë 28 shkurt 2012.

Me 2 mars 2012, M.H në emër të djalit të tij A.H (tani e tutje: ankuesi) ka paraqitur një ankesë në AKP, ku theksonte se A.H kishte blerë ngastrën 444 në vendin e quajtur "Tërska", në sipërfaqe prej 0.30.11 ha, arë të zonës kadastrale Zhegër, Komuna e Gjilanit. Ai ka paraqitur Certifikatën e të Drejtave Pronësore në Paluajtshmeri UL-70403026-01063, të datës 12 maj 2011 që konstaton P.S-in pronar të regjistruar të ngastrës 444; kontratën e lidhur në mes të P.S, nga Zh dhe A.H e cila është vërtetuar nga Gjykata Komunale e Gjilanit, Vr.Nr. 3433/11 me datë 20 shtator 2011; Certifikatën e të Drejtave Pronësore UL-70403026-01064, e datës 20 qershor 2011 që konstaton A.H si pronar të ngastrës së cekur.

Ankesa i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës V.M.

Me datë 4 prill 2012, V.M (tani e tutje: pala përgjegjëse në ankesë) ka ushtruar përgjigje në ankesë. Në përgjigje, ai ka kundërshtuar regjistrimin e tokës e cila i përkiste babait të tij, në emër të P.S (nipit të tij), përkatësisht validitetin e kontratës së shitjes së lidhur midis P.S dhe A.H. Ai ka theksuar se humbja e posedimit të pronës ishte shkak i rrethanave të lidhura direkt ose që rrjedhin nga konflikti i armatosur që ka ndodhë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Me datë 26 qershor 2013, gjyqtari referues ka nxjerrë një urdhër për Kadastrin e Komunës së Gjilanit duke kërkuar historiatin dhe bazën për ndryshim të pronarit të regjistruar për ngastrën kadastrale nr.

444. Në përgjigjen e Kadastrit, të datës 5 korrik 2013, është theksuar se ngastra 444 ishte regjistruar në emër të M.J.D sipas fletës poseduese nr. 115. Sidoqoftë, toka ka kaluar në emër të pronarit të ri, bazuar në vendimin e trashëgimisë Tr.nr. 74/2011 datë 20 maj 2011, përderisa është regjistruar në emër të blerësit të ri A.H sipas kontratës së shitblerjes. Kadastri ka ofruar dokumentet në lidhje me këtë ndryshim, posaçërisht vendimin Tr.nr. 74/2011 i datës 7.4.2011.

Me 16 gusht 2013, M.H ka paraqitur autorizimin të dhënë nga biri i tij Agron Haziri.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e pranueshme.

Sipas Nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, të amendamentuar me Ligjin nr. 03/L-079 mbi zgjidhjen e kërkesave të cilat lidhen me pronën e paluajtshme, duke përfshirë këtu pronën bujqësore dhe atë komerciale, pala mund të ushtrojë ankesë brenda tridhjetë (30) ditësh pas njoftimit mbi vendimit.

Ankesa është e pranueshme edhe pse pala ankuese nuk ka qenë palë në procedurën para KKKP-së. Kjo rrethanë nuk mund të shkojë në dëm të palës ankuese pasi që në të vërtetë ai nuk ka qenë si duhet i njoftuar në lidhje me kërkesën. Njoftimi është bërë përmes publikimit të kërkesës në Gazetën Njoftuese të AKP-së dhe në Buletinin e UNHCR-it. Kjo, megjithatë, përbën “përpjekjet e arsyeshme” për të njoftuar në lidhje me kërkesën siç parashihet me nenit 10.1 të rregullores, vetëm në disa raste: psh në disa procedura civile është e pranueshme të ftohet një person përmes publikimit në gazetën Shtetërore nëse personi ka lënë adresën e njohur të tij/saj dhe nuk ka ofruar adresën e re. Sidoqoftë, kjo zgjidhje nuk mund të jetë gjithmonë e pranueshme në procedurën para AKP-ës meqenëse pala përgjegjëse nuk është e njohur paraprakisht dhe në fillim të procedurës. Prandaj, është e papranueshme që ankuesi ka qenë në dijeni për kërkesën dhe ankesa e tij është e pranueshme.

Sipas Nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër të Komisionit për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e dëshmon pronësinë mbi pronën por edhe që ai apo ajo tani nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat ndaj asaj prone për shkak të rrethanave që direkt ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.

Paraqitësi i kërkesës është njëri nga anëtarët e familjes në kërkesën e pakontestuar në shkallën e parë që pretendon se ka humbur posedimin e ngastrës nr. 444 për shkak të rrethanave të lidhura ose që

rrjedhin nga konflikti i armatosur. Ai ka paraqitur fletën poseduese nr. 115 që konstaton babain e tij pronar të regjistruar dhe KKPK-ja ka pranuar kërkesën.

Nuk është kontestuese se D.M ishte pronar i ngastrës kadastrale nr. 444 në këtë fletë poseduese nr. 115. Sidoqoftë, me paraqitjen e ankesës çështja është bërë kontestuese. Dokumentet e paraqitura pranë Gjykatës Supreme nga ankuesi dhe Kadastri konstatojnë se P.S ishte shpallur si i vetmi trashëgimtar i D.M me vendimin e Gjykatës Komunale të Gjilanit. Çertifikata e të Drejtave Pronësore UL-70403026-01063, e datës 12 maj 2011, konstaton P.S pronar të regjistruar të ngastrës së sipërcekur që ia ka shitur ankuesit A.H me kontratë të shitëblerjes, e cila është vërtetuar nga Gjykata Komunale e Gjilanit. Sipas Çertifikatës së të Drejtave Pronësore UL-70403026-01064, e datës 20 qershor 2011, A.H është regjistruar si pronar i pronës së kërkuar.

Pala përgjegjëse ka kundërshtuar ligjshmërinë e ndryshimit të ndodhur në kadastrë; sidoqoftë ai nuk ka ofruar dëshmi që të mbështesë pretendimin e tij si trashëgimtar i D.M në vend të P.S ose posedimin e pronës për shkak të rrethanave që rrjedhin nga konflikti i armatosur i vitit 1998/1999. Sipas dokumenteve të vërtetuara në Gjykatën Komunale, humbja e pronës është për shkak të rrethanave familjare. Ndryshimi në kadastrë është bazuar në aktvendimin e trashëgimisë dhe në kontratën e shitjes të dyja të vitit 2011. Validiteti dhe efekti ligjor i vendimit të trashëgimisë dhe kontratës së shitjes nuk duhet të analizohet në këtë procedurë, për shkak se kërkesa është jashtë jurisdikcionit të KPPK-ës dhe të Kolegjit të Apelit të AKP-ës. Të drejtat e pretenduara dhe mungesa e tyre si të tilla, rrjedhin ose pengohen nga vendimi i trashëgimisë dhe/ose kontrata e shitjes, mund të kërkojnë para gjykatave kompetente të rregullta.

Meqenëse paraqitësi i kërkesës nuk ka dëshmuar se ai është trashëgimtar i D.M, pronari i mëparshëm i regjistruar i pronës së kërkuar dhe i mëpastajmë nuk ka provuar faktin se ai nuk kishte mundur të gëzonte të drejtën në këtë pronë për shkak të rrethanave që janë drejtëpërsëdrejti të lidhura ose që rrjedhin nga konflikti i armatosur që ka ndodhë në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999; sipas nenit 3.1 të Rregullorës së UNMIK-ut e amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079, kjo çështje nuk bie në kompetencën e organit të caktuar dhe me këtë as edhe të Gjykatës Supreme. Rrjedhimisht, vendimi i KKPK-ës duhet të anulohet për sa i përket kërkesës në fjalë dhe kërkesa ekzistuese të hedhet për shkak të jokompetencës së KKPK-ës dhe Gjykatës, në pëputshmëri me dispozitat e nenit 198, para 1 të LPK-ës.

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, Neni 8.4 i Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë një përjashtim i tillë nuk parashihet për procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme ankimore:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit, për hedhjen padisë maksimumi është 30 euro gjë që përcaktohet në atë shumë, sipas tarifës 10.15 lidhur me tarifën 10.1 sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala përgjegjëse në ankesë e cila ka paraqitur kërkesën e papranueshme. Për më tepër, paraqitësja e kërkesës/pala përgjegjëse në ankesë ka qenë në dijeni për këtë por pavarësisht kësaj ajo kishte paraqitur kërkesën. Sipas nenit 46 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, kur një person me vendbanim jashtë vendit është i obliguar të paguaj një taksë, afati për pagesën e saj nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë dhe as më i gjatë se 90 ditë. Gjykata vendos se afati në këtë rast është 90 (nëntëdhjetë) ditë. Neni 47.3 parashihet që në rast se pala nuk paguan taksën brenda afatit, pala do të duhet të paguaj një gjobë prej 50% të shumës së taksës. Nëse pala nuk e paguan taksën në afatin e dhënë, atëherë bëhet ekzekutimi i detyrueshëm i pagesës.

Udhëzim juridik

Sipas Nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50, i amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta dhe ato jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Esma Erterzi, a, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it